

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Po dërgonte vajzën në shkollë, kamioni përplas për vdekje shqiptaren në Itali
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392487.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 11:41:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	18 shtator 2026, 11:38:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 18 shtator 2026, 11:37:00 UTC → 18 shtator 2026, 11:39:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0b098f0dad7a1939a45e76e437fe0b781a6c75d5a07bd83495ee5197d7ff06ee
TEKSTI	eb5dd702613325dc3791ca86324f574a71e80235b91d1650c0ce2dccdf46aaa2
PAMJA	f4650c3351c2ab67411b3051ddb56b736c041fbc5b433417088f4bb1da5cd14

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a6bff8ef84b089b42d6d2555f84a682717cd4762fdeea8e2dad2cd56876c32bc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a6bff8ef84b089b42d6d2555f84a682717cd4762fdeea8e2dad2cd56876c32bc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Po dërgonte vajzën në shkollë, kamioni përplas për vdekje shqiptaren në Itali

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 18.09.2026, 13:38



Share



Share



Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e sotëm në San Donà di Piave, në provincën e Venecias, Itali.

Lavdije Isteri, 42 vjeçe, me origjinë shqiptare dhe banuese në zonën e Passarellës, humbi jetën pasi u përplas nga një kamion teksa po shoqëronte në këmbë vajzën e saj 9-vjeçare për në shkollë.

Aksidenti ndodhi pak para orës 08:00, në kryqëzimin me rrugën Paolo VI, në një orar kur shumë familje po drejtoheshin drejt shkollës.

Sipas një rindërtimi paraprak të ngjarjes, 42-vjeçarja po ecte duke mbajtur për dore vajzën e saj, kur pranë tyre mbërriti një kamion i madh i kompanisë Veritas. Gjatë një kthese majtas, për shkaqe që ende duhet të përcaktohen nga hetimet, kamioni përplasi gruan.

Për Lavdije Isterin nuk mund të bëhej më asgjë. Ajo humbi jetën në vendngjarje. Vajza e saj 9-vjeçare, e cila ndodhej pranë nënës në momentin e aksidentit, u prek vetëm lehtë nga kamioni dhe mbeti fizikisht e padëmtuar.

Megjithatë, për shkak të tronditjes së rëndë psikologjike, vajza u dërgua në spital, ku mori edhe ndihmën e psikologëve.

Në vendngjarje mbërritën efektivet e policisë lokale dhe zjarrfikësit. Këta të fundit u detyruan të ndërhyjnë për nxjerrjen e trupit të viktimës, i cili kishte mbetur poshtë kamionit. Në vendngjarje ishte edhe kryetari i bashkisë së San Donà di Piave, Alberto Teso.

Edhe drejtuesi i kamionit, i tronditur nga ngjarja, u transportua në urgjencë pas aksidentit.

Policia lokale po vijon hetimet për të rindërtuar me detaje dinamiken e përplasjes. Autoritetet po verifikojnë trajektoren e kamionit, pozicionin e gruas dhe të vajzës, si dhe çdo element tjetër që mund të ndihmojë në përcaktimin e rrethanave të sakta të aksidentit.

Tragjedia ndodhi brenda pak çastesh, gjatë rrugëtimit të zakonshëm të nënës dhe vajzës drejt shkollës. Vajza ndodhej pranë nënës së saj në momentin e përplasjes, por fatmirësisht i shpëtoi goditjes së drejtpërdrejtë nga kamioni.

Siç parashikohet në raste të tilla, autoritetet gjyqësore priten të hapin një procedim për vrasje rrugore, në mënyrë që të kryhen të gjitha verifikimet mbi dinamiken e aksidentit dhe përgjegjësitë e mundshme.

Provat dhe të dhënat e mbledhura në vendngjarje nga policia lokale do t'i vihen në dispozicion prokurorisë, e cila do të vijojë hetimet për zbardhjen e plotë të tragjedisë.



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.